

VENDIM
Nr. 578, datë 18.9.2024

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 365, DATË 16.6.2023,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË
NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE DHE PUNONJËSVE TË DREJTORISË
SË SHËRBIMEVE QEVERITARE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 365, datë 16.6.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve dhe punonjësve të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare”, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Lidhja nr. 2, e përmendur në pikën 4, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Funksionet “Specialist arkivi” dhe “Specialist protokoll” përfitojnë një shtesë mbi pagë, për kushte pune (natyrë të veçantë pune), në masën 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2024, përballohen nga të ardhurat e institucionit.

3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.9.2024.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LIDHJA NR. 2 STRUKTURA E PAGËS SË PUNONJËSVE MBËSHTETËS TË DREJTORISË SË SHËRBIMEVE QEVERITARE			
Funksioni	Kategoria/klasa	Shtesa për vjetërsi (%)	Shtesa për kushte pune (lekë)
Kryekuzhinier kategoria 1	IX	1%	135,000
Kryekuzhinier kategoria 2	IX	1%	75,000
Kryepastiçier	IX	1%	50,000
Kryekamerier	IX	1%	45,000
Administrues Vila 4, Vila 30	IX	1%	70,000
Administrues vila/qendrash	IX	1%	35,000
Ndihmëspastiçier	VIII	1%	35,000
Banakier	VIII	1%	42,500
Kryepunëtor Rezidenca Qeveritare	VIII	1%	35,000
Magazininier i magazinës qendrore; industriale; Parku Delegacioneve; ushqimore; Pallati i Brigadave	VIII	1%	20,000
Magazininier i magazinës dytësore Pallati Kongreseve; rekupero; dytësore Durrës;	VII	1%	20,000

Kuzhinier Rezidenca e Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit; Presidentit	VII	1%	35,000
Kuzhinier Vila Qeveritare	VII	1%	35,000
Teknik elektrikist/hidraulik/mirëmbajtje/ operator shumëfishimi në kryeministri, punëtor në rezidenca qeveritare	VII	1%	35,000
Kamerier	VII	1%	40,000
Shofer/korrier; shofer në Kryeministri	VII	1%	45,000
Teknik të ndryshëm; teknik dispeçer	VII	1%	30,000
Teknik/kameraman, teknik/fotograf	VII	1%	80,000
Shofer	VI	1%	40,000
Punëtorë mirëmbajtjeje; punëtor gjelbërimi; roje magazina industriale; roje Pallati i Kongreseve, lavazhier,	IV	1%	20,000
Punëtor pastrimi, punëtor pastrimi në Kryeministri , punëtor lavanderie; roje/receptionist në Kryeministri	IV	1%	35,000